

BASHKIA
VLORË

MASTER PLANI I PUNËSIMIT

FALENDERIME

Master Plani i Punësimit në Bashkinë Vlorë është një dokument strategjik politikash dhe është krijuar në kuadër të projektit “Jeto Qytetin Tënd-Politikat Rinore në Nivel Lokal” me qëllim përmirësimin e politikave të punësimit dhe gjendjes aktuale të punësimit të të rinjve në Bashkinë Vlorë. E njëjta iniciativë është ndërmarrë edhe në 11 bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Falenderime të veçanta i shkojnë Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung në Tiranë i cili ka mbështetur Kongresin Rinor Kombëtar dhe programin e dedikuar politikave rinore në nivel lokal prej tre vitesh.

Falenderime i shkojnë gjithashtu përfaqësuesve të administratës publike që morrën pjesë gjatë takimeve me fokus grupet përgjatë gjithë hartimit të Master Planit. Pa bashkëpunimin e tyre dhe ndarjen e informacioneve ky master plan nuk do të ishte i njëjti.

Falenderime shkojnë për bashkëautoren, Saniela Xhaferi, koordinatore lokale e qytetit të Vlorës, përfaqësuese e organizatës “TPACenter”. Shpreh mirënjohje gjithashtu ndaj ekspertëve të cilët asistuan 12 koordinatorët lokalë në analizimin e situatës aktuale dhe evidentimin e problematikave dhe sygjërimeve të mundshme për përmirësimin e situatës. Faleminderime kolegëve koordinatorë të cilët ndanë eksperiencat dhe kontributin e tyre gjatë gjithë këtij procesi.

Mbi të gjitha falenderime të përzemërta i shkojnë të gjithë organizatave rinore lokale pjesë apo jo e Kongresit Rinor Kombëtar, pjesëmarrësve, të rinjve, aktivistëve, studenteve dhe qytetarëve të cilët morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre gjatë fazës së konceptimit dhe dizenjimit të këtij dokumenti.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë të Kongresit Rinor Kombëtar dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung.

TABELA E PËRMBAJTJES:

FALENDERIME	
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II. TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS NË KORCË	4
III. OBJEKTIVAT	5
IV. PARIMET UDHËHEQËSE	6
V. ANEKSET	8
ANEKSI I : BASHKËPUNIMI I TË GJITHË AKTORËVE INTITUCIONALË TË TREGUT TË PUNËS	9
ANEKSI II : EDUKIMI DHE TRAJNIMI	12
ANEKSI III : RRIJTJA E MUNDËSIVE TË PUNËSIMIT POLICY OPTION 3	14
ANEKSI IV : AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM	16
ANEKSI V : SIPËRMARRJA	16
ANEKSI VI : PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL	18

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një nga vendet me popullësinë më të re në rajon ku të rinjtë nën moshën 30 vjeç përfaqësojnë 45.6% të popullësisë.

Në qarkun e Vlorës të rinjtë përbëjnë _____ të gjithë popullësisë duke e renditur si qarkun e parë me përqëndrimin më të lartë të të rinjve në vend. Ndërkohë ky përqëndrim në njësitë administrative rurale shkon në _____.

Ky rezultat është i ndikuar jo vetëm nga përqëndrimi i lartë i institucioneve arsimore në vend por dhe nga numri i lartë i bizneseve dhe standarti i jetesës. Për këto arsye kjo grup moshë kërkon një trajtim të veçantë dhe duhet të merret në konsideratë të vazhdueshme në hartimin e dokumentave strategjikë pasi ata përbëjnë forcën më të lartë punëtore në vend dhe janë komponentë kryesore për zhvillimin e qytetit dhe vendit.

Ky masterplan vjen si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të Kongresit Rinor Kombëtar për të influencuar politikën rinore në nivel vendor dhe qendror me qëllim fuqizimin e të rinjve në 12 qarqet e vendit. Konkretisht në vitin 2017 Kongresi Rinor Kombëtar së bashku me institucionet publike dhe organizatat e saj partnere hartuan Planet Lokale Vendore, dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin strategjik të të rinjve në 12 qarqet e Shqipërisë.

Në kuadër të projektit “Planet Lokale të Veprimit për Rininë - Jeto Qytetin Tënd” kemi zhvilluar takime dhe diskutime me grupime të të rinjve dhe organizatave rinore në 12 qarqet për të identifikuar problematikat dhe zgjidhjet e mundshme që prekin grupmoshën 15-29 vjeç.

Punësimi rinor mbetet një problem madhor në rang kombëtar i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga organizatat rinore në bashkëpunim me autoritete lokale dhe komunitetin e biznesit. Për këtë qëllim ne kemi hartuar Masterplanin për Punësimin e të Rinjve në bashkitë përkatëse.

Ky masterplan i dedikohet vetëm Bashkisë Vlorë dhe ka si qëllim paraqitjen e situatës aktuale të punësimit të të rinjve në këtë bashki si dhe hartimin e objektivave strategjikë shoqëruar me rekomandimet përkatëse.

Ky dokument është i ndarë në pesë pjesë kryesore dhe është në vijueshmëri me dokumentat në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

II. TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS NË KORCË

Në nivel kombëtar çështja e punësimit është një nga pesë prioritetet e kyçe të qeverisë por edhe në nivel lokal kjo çështje ka marrë një fokus të veçantë.

Kjo pasqyrohet edhe në dokumentet strategjike të hartuara në nivel qendror dhe vendos siç janë: Programi i Qeverisë 2017-2021; strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020; Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020, Plani Kombëtar Veprimi 2010-2015.

Në nivel lokal paraqitet në dokumentat si:

Për të arritur një mirë-menaxhim të burimeve natyrore, financiare dhe kapitalit njerëzor në nivel kombëtar dhe lokal është e nevojshme të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe e mirë detajuar e tregut të punës për të matur atë se çfarë kërkohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vendin e punës për të dalë me përfundime dhe rekomandime konkrete. Ajo çka duhet të theksohet është fakti se kjo analizë mungon çka e bën jo të qartë për aktorët që punojnë se ku duhet ti prioritetizojnë fondet dhe veprimet e tyre. Mbivendosja e punës, ripërsëritja dhe kosto janë problematika që vijnë pikërisht nga kjo mungesë.

Përsa i përket punësimit, Bashkia Vlorë ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të marginalizuara. Aktualisht janë zhvilluar një sërë politikash dhe programesh si:

Plani lokal i veprimit për rininë 2013-2015 për Bashkinë Vlorë

Lidhur ngushtë me punësimin lidhet dhe çështja e aftësisimit e cila synon krijimin e një force punëtore të kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut. Për këtë arsye është e nevojshme hartimi i politikave dhe programeve plotësuese siç janë: trajnimet, praktikat dhe edukimi jo-formal.

Përsa i përket mbështetjes financiare dhe nxitjes së punësimit Bashkinë Vlorë do të fokusohet në dy programe kryesore siç janë: Punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve dhe rritja e kapaciteteve të të rinjve për tu integruar më mirë në vendin e punës.

III. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij MasterPlani janë si më poshtë:

1. Vendosja e një Plani Masash të Përbashkëta midis 4 aktorëve kyç në nivel vendor, Drejtorisë Rajonale të AKPA (dikur Zyra e Punës), Zyrës Arsimore Vendore dhe Universiteteve, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe së fundi Bashkisë. Ky bashkëpunim të jetë në disa faza:
2. Sigurimi i aksesit të të rinjve në shërbimet për zhvillimin e karrierës
3. Nxitja e rolit të sektorit privat në krijimin e vendeve të punës së denjë për të rinjtë
4. Informimi dhe ndërgjyegjësimi i të rinjve mbi të drejtat e tyre në punë
5. Të krijojë një kuadër cilësor dhe dinjiteti për punësimin e të rinjve.
6. Të formojë të rinjtë si agjent ndryshimi të situatës së tyre drejtë integritimit në tregun e punës.
7. Të ofrojë asistencë të personalizuar në zhvillimin personal të të rinjve dhe mundësive të karrierës në _____ dhe NJA rurale.
8. Të përmirësojë integrimin dhe qëndrueshmërinë e të rinjve në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit personal dhe profesional dhe kualifikimeve të vazhdueshme.
9. Zhvillimi i ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të ekonomisë qarkulluese dhe biznesit social.
10. Rritja e aksesueshmërisë së tregut të punës dhe programeve të aftësimi për grupet e marginalizuara dhe gratë dhe vajzat.
11. Të sigurojë përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në tregun e punës dhe mundësi të barabarta të punësimit dhe zhvillimit profesional.
12. Të rrisë bashkëpunimin midis aktorëve publik dhe privat që operojnë në fushën e punësimit, zhvillimit të karrierës dhe kualifikimeve profesionale.



IV. PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet udhëheqëse janë në përputhshmëri me strategjitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të punës tek të rinjtë. Ato janë baza mbi të cilat do të hartohen dhe dizajnohen të gjitha veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes aktuale të punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.


Përshtatja me direktivat Europiane: Më hyrjen në Bashkimin European tregu i punës në Shqipëri do të përballet me një sërë ndryshimesh ndaj është e nevojshme të kuptojmë këto ndryshime duke filluar nga: standarti i tregut të punës, konkurrueshmëria në aftësitë profesionale, kuadri ligjor dhe institucional, dixhitalizimi, lëvizja e lirë e mallrave dhe standarti i produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të ndërmarrim hapa që në një plan afatgjatë do ti shërbejnë pikërisht këtyre ndryshimeve si dhe minimizimit të rreziqeve dhe kostove të bizneseve shqiptare dhe punonjësve shqiptarë.

Zhvillimi i Qëndrueshëm: Ky parim udhëheq çdo dokument strategjik që hartohet në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Menaxhimi i burimeve dhe planifikimi i integruar social dhe ekonomik janë shtyllat kryesore ku mbështetet ky parim.

Bashkërendimi: Ky master plan është hartuar duke u bashkërenduar me dokumentat strategjikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar më qëllim harmonizimin e punës dhe zhvillimin e aktiviteteve në të mirë të interesave qytetare dhe grupeve të synuara kryesisht të rinjtë.

Punësim Cilësor: për të gjithë: Ky parim synon zhvillimin e individëve duke ofruar asistencë të personalizuar në të gjitha fazat përgatitore drejt tregut të punës si dhe aftësimin dhe trajnimeve të vazhdueshme.

Gjithëpërfshirja dhe Mos-diskriminimi: Ky parim siguron përfshirjen sociale duke u fokusuar më së shumti tek grupet e marginalizuara siç janë gratë dhe vajzat, vajzat që janë viktimat e dhunës, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë në zona rurale dhe emigrantët. Gjithashtu ky parim siguron mundësi të barabarta punësimi dhe kualifikimi të individëve që vijnë nga këto grupe.



Mbështetja e prodhimit vendas dhe ekonomisë lokale: Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian është e rëndësishme zhvillimi i tregut lokal dhe rajonal të punës, produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye nxitja e prodhimtarisë dhe ekonomisë lokale do të shoqërohet me krijime të reja të vendeve të punës dhe uljes së papunësisë. Ky parim mbështet të gjitha nismat dhe programet që do të ndërmerren në kuadër të këtij master plani.

Zhvillimi personal dhe profesional: Ky parim synon të vendosë të rinjtë në qendër të gjithë nismave në mënyrë që të rrisë kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e të rinjve për tu përshtatur në vendin e punës. Ky parim do të mbështetet në ciklin e zhvillimit personal dhe profesional duke i bërë të rinjtë agjentë ndryshimi të jetës së tyre.

Bashkëpunim dhe dialog konstruktiv: Për të arritur sa më mirë përmbushjen e objektivave të këtij dokumenti është e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë aktorët e përfshirë si: institucionet lokale, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e arsimit të mesëm, institucionet e arsimit profesional, komuniteti i biznesit, akademikë dhe studiues, organizatat rinore, organizatat e biznesit, sindikatat e punëtorëve dhe të rinjtë.

Analizë paraprake e situatës

Cfarë është bërë deri më tani dhe cfarë është parashikuar realisht, qoftë në dokumentat strategjike kombëtare apo edhe në veprimtari konkrete midis aktorëve vendorë që lidhen me punësimin, dëshmon se nuk kanë qenë në optimumin e politikave që i përgjigjen nevojave të këtij problemi, “punësimin të të rinjve”.

Sigurisht që disa praktika kanë rezultuar të efektshme në lokalitete të ndryshme dhe është e logjikshme/e pritshme që ato të vijojnë të ndiqen jo vetëm aty ku kanë qenë të efektshme, por edhe të huazohen dhe adaptohen në komunitete të tjera. Këto do t'i konsideronim si rekomandimin e parë, pra **Policy Option 1**.

Duke konsideruar diferencat nga një lokalitet në të tjetrin, këto praktika/politika duhen rishikuar brenda një konteksti më të gjerë, që rezultatet të jenë më gjithëpërfshirëse por dhe praktikisht të aplikueshme/zbatueshme.



Si disa nga faktorët për t'u konsideruar në (mos)efektshmërinë e këtyre praktikave/politikave do të listonim,

1. Faktorë që vijnë për shkak të tipareve të ekonomisë që shfaq një lokalitet i caktuar, si:

- sektorët prioritarë që prodhojnë vende pune;
- punësim sezonal apo gjithëvjeter;
- punësim në sektor prodhues apo shërbime;
- raporti i punësimit në sektorin shtetëror me atë në sektorin privat;
- punësim në sektorë që ofrojnë vetëpunësim ose punësim në ekonomi familjare

2. Faktorë që vijnë për shkak të dinamikave që shfaqin të rinjtë në ato lokalitete, si:

- ndjekin ose jo arsim të lartë;
- degët/profesionet më të zgjedhura më të shumta;
- kualifikim profesional apo akademik/universitar;
- formim profesional në shkollat e mesme profesionale (3-5 vjet) apo formim profesional me kurse (3-6 muaj) në Qendrat e Formimit Profesional;

V. ANEKSET

Për të arritur përmbushjen e objektivave të lartë përmendura është e rëndësishme të formulojmë masterplanin e punësimit i cili është i ndarë në gjashtë anekse.

Qëllimi: Prioritizimi i aksioneve që do të ndërmerren në vitet pasardhëse kryesisht për reduktimin e numrit të të rinjve të papunë, përmirësimin e cilësisë së forcës punëtore, fasilitim drejt vendit të punës dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në tregun e punës për të kontribuar në promovimin e punësimit të plotë dhe produktiv për të rinjtë.

ANEKSI I: BASHKËPUNIMI I TË GJITHË AKTORËVE INTITUCIONALË TË TREGUT TË PUNËS

Qëllimi kryesor: Informimi, orientimi profesional, motivimi, këshillimi, diagnostifikimi dhe përcaktimi i profilit të karrierës përfshirë këtu edhe kompetencat, kërkimi për një vend pune dhe ndërmjetësimi në tregun e punës.


Ky aneks përfshin objektivat e mëposhtme:

OBJEKTIV: Vendosja e një Plani Masash të Përbashkëta midis 4 aktorëve kyç në nivel vendor, Drejtorisë Rajonale të AKPA (dikur Zyra e Punës), Zyrës Arsimore Vendore dhe Universiteteve, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe së fundi Bashkisë.

Ky bashkëpunim të jetë në disa faza:

Së pari, një hapje e zyrës së punës për të afruar të gjithë të rinjtë që janë në moshë punë, të regjistrohen si punëkërkues. Kjo etapë të realizohet në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit dhe Universitetet. Në profilizimin që i bëhet punëkërkuesit, dalin të qarta aftësitë, kualifikimet dhe punësimet e mëparshme nëse ka patur. Ky profilizim do të lehtësojë kategorizimin e tyre dhe njëkohësisht do të jetë më e lehtë të orientohet në një vend pune që i përshtatet aftësive të tij. Kjo do të sjellë më shumë mundësi pikëtakimi të kërkesës për punë me ofertën e punës.

Një tjetër pjesë e bashkëpunimit të Zyrës së Punës me ofruesit e arsimit (të mesëm dhe të lartë) do të jetë përfshirja e nxënësve dhe studentëve në Programet e Nxitjes së Punësimit. Kjo përfshirje e të rinjve të mos jetë rastësore, në rastin më të mirë, dhe në rastin më të keq mos të jetë një paracaktim/përzgjedhje preferenciale e atyre të rinjve që bëhen pjesë e PNP. Pra, të synohet një shpërndarje sipas profilit të të rinjve, kualifikimit të tyre (BA, MSc, MP) dhe targetit që ka përqindjen më të lartë të papunësisë (pra të rinjtë që hyjnë për herë të parë në tregun e punës apo të tjerët që synojnë kualifikim të mëtejshëm).



Së dyti, angazhimi periodik (1 herë në muaj) i përbashkët i ZP, Bashkisë dhe operatorëve ekonomikë lokalë, me ndërmjetësimin edhe të DHTI, të qarkullimit të informacionit, shëprndarjes në kohë reale të ofertave të punësimit dhe gjetjes, gjurmimit të të rinjve që hasin vështirësitë më të mëdha. Kjo të jetë me fokus kryesisht në zonat rurale dhe në periudhën e sezonit turistik.

Si një hallkë fundore e bashkëpunimit të jetë edhe një marrëdhënie konstante me Inspektoratin Shtetëror të Punës për evidentimin, denoncimin e rasteve të punësimit jo të denjë dhe të mosrespektimit të të drejtave të të rinjve në punë; shkelja ose mospasja e kontratave të punës.

Këshillimi i karrierës dhe asistencë e personalizuar

Këshillimi i karrierës është një fazë shumë e rëndësishme e cila i paraprin fazave pasardhëse për kërkimin e vendit të punës. Kjo fazë është e lidhur ngushtë me zhvillimin personal të individëve dhe formimin e tyre të përgjithshëm dhe akademik. Kjo fazë është e një rëndësie të veçantë pasi nëse hartohet dhe zhvillohet në mënyrën e duhur sjell reduktimin e një sërë kostove duke filluar nga kostot financiare dhe sociale dhe duke sjellë kështu reduktim të dukshëm të numrit të papunësisë. Gjithashtu kjo fazë i shërben individëve të riorganizojnë dhe të mirë menaxhojnë burimet e tyre, njohuritë dhe aftësitë për një kërkim më efikas të mundësive aktuale të punësimit në Bashkinë Vlorë por dhe për zhvillimin e mundësive të reja në këtë territor.

Aksioni 1: Formimi i Grupit Këshillimor të Karrierës

Sfida e realizimit të një analize të mirëfilltë të tregut të punës sjell me vete vështirësi për të kuptuar realisht cilat janë nevojat e punëkërkuesve dhe punëmarrësve në tregun e punës në Shqipëri. Kjo është një sfidë në nivel kombëtar dhe lokal i cili ka nevojë për një ndërhyrje sa më të shpejtë.

Formimi i **Grupit Këshillimor të Karrierës** synon më tej formimin e një grupi prej 100 individësh në nivel lokal të kualifikuar specifikisht për orientimin dhe këshillimin e të rinjve. Ky hap përfshin këshillim të personalizuar të individëve sidomos të rinjve duke u bazuar tek interesat, aftësitë e tyre, nevojën e tregut të punës dhe politikat shtetërore. Ajo çka e lidh këtë grup me analizën e tregut të punës është pikërisht analizimi i nevojave specifike të punëkërkuesve dhe fasiliteti i tyre në procesin e zhvillimit personal dhe profesional.

Puna e Grupit Këshillimor të Karrierës do të komplementohet nga **një grup ndërmjetësuesish** rinorë të cilët do të vijnë nga organizatat rinore.

Grupi Këshillimor i Karrierës do të hartojë një Program Individual Orientimi i cili do të përfshijë: diagnostifikimin personal, planin personal të zhvillimit dhe planin personal të trajnimit dhe kualifikimit. Në mënyrë që të zhvillohet ky program është e rëndësishme që grupi i këshilluesve të trajnohet paraprakisht dhe të pajiset me informacionin dhe aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses fazën e parë. Ky grup duhet të përfshijë ekspertë të fushës, punonjës të burimeve njerëzore, trajnerë dhe mentorë lidhur me zhvillimin personal dhe profesional, përfaqësues nga organizata rinore dhe nga institucionet e përfshira në hartimin e këtij programi si dhe përfaqësues nga institucionet arsimore dhe komuniteti i biznesit. Hartimi i këtij programi do të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe mos-diskriminimit.

Aksioni 2: Diagnostifikimi dhe Programi Individual i Orientimit Drejt Tregut të Punës

Aksioni 3: Formimi i grupit të Ndërmjetësuesve Rinorë

Aksioni 4: Këshillim gjithëpërfshirës i të rinjve që vijnë nga zonat rurale, gratë, vajzat, komunitete të ndryshme në Shqipëri si dhe personat me aftësitë të kufizuara.

Raporti me Aktorët e Tregut të Punës

Një objektiv tjetër i Programit Individual të Orientimit do të jetë dhe krijimi i urave lidhëse midis aktorëve të ndryshëm që janë pjesë aktive e tregut të punës. Këtu përfshihen institucionet arsimore të arsimit të lartë, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, agjensitë shtetërore lidhur me punësimin, komuniteti i biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ky aksion parashikon takime dhe trajnime të përbashkëta të aktorëve të përfshirë kryesisht rreth zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të punës dhe një qasjeje më miqësore për të rinjtë në formën e praktikave, punës në distancë apo teorisë dhe praktikës së integruar.

Gjithashtu është e nevojshme të trajnohet komuniteti i biznesit me qasjen europiane dhe aftësinë për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian. Aftësia për tu përshtatur me ndryshimet që do të pësojë ky komunitet me hyrjen në BE mund të krijojë hapësira për punësimin dhe integrimin e të rinjve në strukturat e tyre.



ANEKSI II: EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Fusha e edukimit dhe trajnimit është një fushë shumë e gjerë dhe Vlora ndonëse ofron mundësi dhe aktorë që punojnë intensivisht në këtë fushë është e rëndësishme të theksohet se duke qenë se tregu është në lëvizje të vazhdueshme nevoja për trajnime dhe kualifikime është gjithmonë prezente. Ky aneks synon të përmbushë objektivat e mëposhtme:

OBJEKTIV: Përmirësimi i Forcës Punëtore të Kompanive dhe Bizneseve

Kapitali njerëzor është një nga asetet më të çmuara të një biznesi dhe është gjithashtu një kapital i cili ka në dorë jetëgjatësinë dhe prezencën e një biznesi në tregun e punës. Me këtë nënkuptojmë se në nivel lidërsipari vendimet që drejtuesit marrin për bizneset apo punonjësit e tyre përcaktojnë edhe të ardhmen e një biznesi. Duke qenë se tregu i punës është i ndryshueshëm i ndikuar më së shumti nga faktori demografik, klimatik, politik dhe teknologjik nevoja për të përshtatur kapitalin njerëzor me këto ndryshime është thelbësore në qëndrueshmërinë e një biznesi. Me integrimin në BE, Shqipëria do të pësojë ndryshime në shumë fusha dhe komuniteti i biznesit është ai që ka një rrezikshmëri të lartë nëse liderët e bizneseve nuk ndërgjëgjësohen dhe informohen në lidhje me këto ndryshime. Konkurrenca, standartet e reja, formalitete dhe zhvillimi i aftësive janë disa nga sfidat kryesore.

Aksioni 1: Krijimi i Mundësive për Kualifikime Profesionale Dhe Zhvillimi i Aftësive që Lidhen me Tregun e Punës

Aksioni 2: Marrëveshje Bashkëpunimi Midis Shkollave dhe Bizneseve

OBJEKTIV: Suport drejt Tranzicionit në Tregun e Punës nëpërmjet zhvillimit të Aftësi dhe Kompetencave

Për të rritur shancet për integrimin në tregun e punës është e nevojshme që fuqia punëtore të njohë shumë mirë si funksionon tregu, si ndryshon dhe se si ata mund të përshtaten më këto ndryshime. Në këtë objektiv fokusi kryesor do të jetë zhvillimi i kompetencave bazë jo vetëm për të përmbushur një CV të pasur por edhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës. Aksionet për të përmbushur këtë objektiv do të hartohen në formën e programeve të cilat do të lancohen nga Zyra e Karrierës në Bashkinë Vlorë dhe do të përfshijnë:

Aksioni 1: Trajnime mbi kompetencat bazë

Aksioni 2: Trajnime mbi kompetencat dixhitale

Aksioni 3: Trajnime mbi gjuhët e huaja dhe mundësitë e mobilitetit për studime dhe punë

Aksioni 4: Trajnime në sektorët strategjik kryesisht lidhur me aspektin profesional

Aksioni 5: Trajnime në bujqësi, blegori dhe agroturizëm si potencial për zhvillimin ekonomik në nivel lokal

Aksioni 6: Programe bursash për studentët në vështirësi ekonomike që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta

Aksioni 7: Trajnime për inovacionin në edukim dhe trajnim

Aksioni 8: Trajnime midis brezave të ndryshëm për shkëmbim informacioni dhe kompetencash

Aksioni 9: Trajnime për stafet e bizneseve apo institucioneve për asistimin e grupeve të marginalizuara në tregun e punës dhe gjithëpërfshirjen.



ANEKSI III: RITJA E MUNDËSIVE TË PUNËSIMIT POLICY OPTION 3

Ky aneks i dedikohet kryesisht grupeve të marginalizuara në mënyrë që të nxisë punëdhënësit të punësojnë, krijojnë hapësira dhe të mbajnë në punë individë të cilët kanë vështirësi në ndërrimin e punës dhe gjenden në situatë ku kanë nevojë për suport ekonomik. Këtu përfshihen kryesisht personat më aftësi të kufizuar, gratë viktime të dhunës, emigrantët, viktime të terrorizmit apo të rinjtë që kanë probleme në familje dhe strehohen në qendra sociale.

Të rinjtë kanë më pak të ngjarë të kenë kontakte për të mësuar rreth hapjes së vendeve të punës, veçanërisht ato kur reklamohen në mënyrë informale. Edhe nëse dëgjojnë për një pozicion, ata mund të mos kenë besim ose përvojë dhe të dijnë si të aplikojnë (p.sh. shkrim CV, aftësi intervistimi). Sigurimi i ndihmës në procesin e kërkimit të një pune shpesh është gjetur metoda me kosto efektive për të asistuar të rinjtë të gatshëm për të punuar (p.sh. punëtorë që përqendrohen në mënyrën e të shkruarit të një rezyme dhe kontakti me një punëdhënës të mundshëm), duke siguruar kthime pozitive si për fitimet më të larta ashtu edhe për punësimin.

Të rinjtë kryesisht janë më të pasigurtë pasi mund të bien më lehtësisht pre e abuzimeve dhe të përjashtohen nga aksesueshmëria në vendin e punës.

Ky aneks synon përmbushjen e objektivave si më poshtë:

OBJEKTIVI: Sigurimi i aksesit të të rinjve në shërbimet për zhvillimin e karrierës

Aksion 1: Monitorimi i disa shkollave pilot (arsim i mesëm dhe i lartë) në mënyrën si ofrohet këshillimi i karrierës;

Aksion 2: Organizimi i Carrier Day në institucione të ndryshme të arsimit publik dhe privat;

Aksioni 3: Organizimi i përvitshëm i panairit të punës (sektori publik dhe sektori privat);



OBJEKTIVI: Nxitja e rolit të sektorit privat në krijimin e vendeve të punës së denjë për të rinjtë

Aksion 1: Vënia në dispozicion e një sistemi stimujsh, ku përfshihet pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe dhënia e granteve për trajnim me qëllim që ndërmarrjet të punësojnë punëtorë të rinj me aftësi të ulëta

Aksion 2: Rishikimi i kriterëve të përzgjedhjes së projekteve të infrastrukturës duke synuar që ato të përputhen me objektivat për zhvillimin në zonat rurale, punësimin

Aksioni 3: Mobilizimi i firmave më të njohura në Qarkun e Vorës për të promovuar punësimin e të rinjve

OBJEKTIVI: Informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve mbi të drejtat e tyre në punë

Aksion 1: Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi dhe informimi mbi efektin negativ të ekonomisë informale.

Aksion 2: Krijimi i një networku midis shkollave-institucioneve-biznesit

Aksioni 3: Portal online dhe databasë e punëkërkesve dhe punëmarrësve

Aksioni 4: Programi mbështetës për grupet vulnerabël

Aksioni 5: Projekte Pilot mbështetur në ekonominë qarkulluese

Aksioni 6: Programi për suportin dhe promovimin e talenteve

ANEKSI IV: AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM

Bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes, ky aneks synon krijimin e mundësive të barabarta për individët dhe sidomos të rinjtë që vijnë nga shtresat e varfra, komuniteti rom, aftësia e kufizuar, zonat rurale dhe gratë dhe vajzat si dhe viktimat e dhunës në familje.

OBJEKTIV: Barazia Gjinore dhe Gjithëpërfshirja në Tregun e Punës

Aksion 1: Krijimi i bashkëpunimit me aktorët që punojnë me barazinë gjinore

Aksion 2: Programi i start-upeve për gratë dhe vajzat në teknologji

Aksioni 3: Programi i mbështetjes së grave dhe vajzave në zonat rurale

Aksioni 4: Programi i mbështetjes së grupeve të marginalizuara.

Aksioni 5: Identifikimi i të rinjve që rrezikojnë të lënë herët shkollën dhe vendosja e mekanizmave parandalues

ANEKSI V: SIPËRMARRJA

Ky aksion lidhet ngushtë me aktivitete që promovojnë sipërmarrjen, vetë-punësimin dhe bizneset sociale me qëllim zhvillimin e ekonomisë lokale në qendër dhe zonat rurale të Vlorës. Programet do të lidhen kryesisht me dhënien e granteve dhe krijimit të një grupi donatorësh që të sigurojnë qëndrueshmërinë e fondeve në fushën e sipërmarrjes.



OBJEKTIV: Promovimi i Sipërmarrjes

Aksioni 1: Krijimi i një networkut të donatorëve

Aksioni 2: Promovimi i biznesit social

Aksioni 3: Inkubatori i biznesit

OBJEKTIV: Trajnim dhe Këshillim i Specializuar për Bizneset dhe Sipërmarrësit

Aksioni 1: Trajnime dhe Certifikime Profesionale

OBJEKTIV: Promovimi i Bizneseve Lokale dhe Brandeve Shqiptare

Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun kombëtar dhe rajonal është e rëndësishme zhvillimi i brendshëm i ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme. Për ti shërbyer kësaj objektivë i duhet dhënë një shtysë bizneseve lokale sidomos atyre në zonat rurale me fokus në: turizëm, bujqësi, blegtori, artizatat dhe kulinari.

Aksioni 1: Zhvillimi i Panairit të Biznesit Lokal

OBJEKTIV: Bashkëpunim midis Aktorëve që Punojnë në Sektorët Strategjikë të Sipërmarrjes dhe Vetëpunësimit

Networku është gjithmonë një mundësi e mirë që bizneset të zgjerojnë tregun e tyre dhe të rrisin mundësitë e bashkëpunimit. Për këtë arsye është e rëndësishme të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve lokale dhe bizneseve lokale ose midis dy bizneseve lokale me qëllim zhvillimin e projekteve të përbashkëta.



ANEKSI VI: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

Në nivel lokal është e rëndësishme që institucionet të luajnë një rol rregullator dhe fasilitues midis aktorëve.

Aksioni 1: Krijimi i një Platforme Online të Punësimit

Aksioni 2: Fasilitimi në Shkëmbimin e Informacionit

Aksioni 3: Të Nxisin Projektet Pilot me Donator nga Bizneset Lokale

